

LETËRSIA DHE ARTI

Vepra e artit në epokën e letërsisë

Leonita PARALLANGAJ¹

¹Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, departamenti i letërsisë, Master i Shkencave

²Email: leonitaparallangaj44@gmail.com

Abstrakt

Në botën e zhvillimit të teknologjisë, sundimi i njeriut mbi njeriun sa vjen e zgjerohet dhe bëhet më i efektshëm në pikën më kulminante të qytetërimit. Në qendër të këtij punimi është vepra e George Orwell, "1984", të cilën e kemi vështruar në mënyrë komparativiste me veprën e Herbert Marcuses, "Njeriu njëdimensional". Vëmendja jonë u përqendrua në realizimin e disa objektivave si, theksi i veçantë që Orwell i ka vënë përparimit teknologjik dhe degradimit shpirtëror, humbjes së zotërimit të aftësisë për të menduar, skllavërimin të vullnetshëm, lirisë së individit. Nga ana tjetër do të dalin në pah dhe do të theksohen ngjashmëri me veprën e Marcuses, ku do të ndalemi te parimet e gjuhës së re dhe te uniformizimi i stilit, punës dhe njeriut të dy këta autorë. Punimi është realizuar duke përdorur metodën semiotike, analizën tekstore, metodën historike dhe metodën komparativiste për të nxjerrur në pah analogjitë dhe tiparet e veçanta të autorëve në fjalë. Të gjitha këto metoda, na kanë çuar në përfundime sa përgjithësuese aq edhe specifike për punimin tonë. Për realizimin e punimit është shfrytëzuar literaturë e ndryshme, ekzistenca e burimeve të mundshme të informacionit është vjelë në terrenin shqiptar dhe në atë të huaj, po kështu, janë shfrytëzuar artikujt teorik, shkrime dhe studime, të cilat na kanë shërbyer si model orientues për punën tonë.

Fjalë kyçe: telekran, vizion i së ardhmes, reformja, njeriu njëdimensional, vdekje shpirtërore, vështrim krahasues.

Hyrje

Në bazë të përqendrimit dhe objektivit të përcaktuar për analizë dhe studim, punimi është i ndarë në dy pjesë, ku do të përvijohen çështjet e hulumtuara më konkretisht. Me anë të këtij punimi synohet që zhvillimi i botës së teknologjisë të shihet nga një prizëm tjetër, në atë të degradimit shpirtëror që po i bëhet njerëzimit.

Kështu, në pjesën e parë jemi ndalur te zhvillimi i shoqërisë dhe teknologjisë gjatë periudhave të ndryshme, për të theksuar edhe më shumë ndryshimin që po pëson shoqëria e sotme. Do të ndalemi te "vdekja e artit", "skllavërimi i vullnetshëm", riprodhimi i veprës së artit si pasojë e argëtimit dhe kënaqësisë, duke sjellë kështu shembuj të kryeveprave botërore, të cilat iu kanë nënshtuar sferës së prodhimit.

Kurse, në pjesën e dytë do të flasim për atë që Marcuse e quajti "njeri njëdimensional", koncepti i turmës, koncepti i refolmes dhe te parimet e gjuhës së re.

Vepra e artit në epokën e teknologjisë

Në botën e zhvillimit të teknologjisë, sundimi i njeriut mbi njeriun sa vjen e zgjerohet dhe bëhet më i efektshëm në pikën më kulminante të qytetërimit. Kampet e përqendrimit, shfarosjet në masë, luftrat botërore nuk janë aspak më ndryshe, se ajo që arritet moderne po i japin njeriut me shkencën. Rruga e emancipimit nëpër të cilën ka kaluar njeriu, u arrit me çmimin e lartë të humbjes së lirive, e ky emancipim u shndërrua pak nga pak me dominimin e njeriut nga njeriu. Në historinë e njerëzimit kemi emra të autorëve që parashikuan këtë degradim shpirtëror, “vdekje e artit”, uniformizim, duke i vënë theks të veçantë zhvillimit të teknologjisë si pasojë e asaj që do të ndodh. Disa nga këta emra janë: Sokrati, Hegel, Walter Benjamin, George Orwell, Jack London, Evgenij Zamjatin, Wells, Oldous Huxley, Herbert Marcuse, Umberto Eco, Shkolla e Frankfurtit me Theodor Adorno, Max Horkheimer, Erich Fromm, Grossman, Franz Neumann e shumë emra të tjerë.

Në një periudhë me zhvillim industrial e teknologjik si kjo e jona, ku pothuajse secili mund t’i prekë artet e bukura thjesht duke prekur një buton, tëhuajtja artistike po i dorëzohet këtij procesi teknologjik. Kështu opera, koncerti, teatri, muzeu, veprat letrare, po i përkasin një tjetër realiteti, një tjetër epoke, e cila po përfundon nga shoqëria e përparuar teknologjike, që ka zhvlerësuar artin në përgjithësi, por ka përjashtuar edhe disa “stile”. Marrim shembull *Zonjën Bovari* të Flaubertit, imazhi i së cilës është zbehur përpara këtij realiteti, sepse shoqëria ku ajo ndodhi ishte shoqëri e prapambetur, me një moral seksual të paliberalizuar, apo shembullin e Ana Kareninës, e shumë shembuj të tjerë të letërsisë shqipe që i gjejmë te Migjeni, Kadare, Nazmi Rrahmani, Haki Stërmilli, që shoqëria i ka keqkuptuar, kundërshtuar dhe refuzuar.

Për raportin që ne kemi sot me veprat dhe mënyrën sesi vepra ka humbur vlerën kulturore dhe është kthyer në një vlerë ekspozuese, Hegeli te “Estetika” na paralajmëron se “vepra e artit, në destinimin e saj supreme është diçka e së shkuarës”. Pra, Hegeli parathotë fundin e një epoke kur vepra e artit është unike dhe zotëron aurea-n e saj dhe fillimin e një epoke ku vepra e artit do të riprodhohet pafundësisht, do të përfshihet në sferën e prodhimit dhe do të shndërrohet në sinonimi me argëtimin dhe kriteri i vetëm do të jetë audienca. Në qoftë se produkti apo vepra e artit nuk përmbush këto kritere do të vuajë pafuqinë ekonomike.

Pra, shoqëria shfrytëzon strategjitë e paradoksit dhe të ironisë, mohon raportin tonë me realitetin, vë në provë konsumatorin dhe intelektualin e tij. Në anën tjetër duke u futur në qarkun e konsumit, futemi brenda një realiteti ku individët realizojnë komunikim në mes të prodhimit dhe konsumit, të cilat ishin të ndara në të shkuarën, por sot, në kohën që po flasim janë të pashkëputshme nga njëra-tjetra.

Për ta konkretizuar atë që Hegeli ka thënë dhe që është pjesë e aktualitetit tonë dëshmohet fare mirë kur vepra e artit është e pranishme jo më në tempuj, kisha e muze, por në rrugë, në supermarkete ku shpeshherë dëgjojmë pjesë nga Beethoven-i, Mozart-i, apo imazhi i Mona Lizës, veprat e Vincent van Gogh-ut, Pablo Picasso-s, të stampuara në bluza, çanta, e çorape, duke iu ndryshuar rrënjësisht qëllimi dhe funksioni i këtyre veprave. Kështu, vepra e artit e riprodhuar për kënaqësinë e çdo të dytit person që do të ketë çantë, çorape apo çdo objekt tjetër me imazhin e Mona Lizës, puthjen e Gustav Klimt, orën e Salvador Dalisë, natën me yje të Goghut, autoportretet e Fridës, e humb sakralitetin e tyre, duke përfunduar thjesht si prodhim për të kënaqur masën.



E gjitha kjo shndërrohet në një proces të humbjes së zotërimit të aftësisë për të menduar, vë në rrezik lirinë e individit dhe njeriu nuk është më një qenie e aftë të kundërshtojë atë çka i ofrohet, por merr në zotërim atë që ofron masa. Pra, konvencionalja shijohet pa asnjë kritikë. *“Tirania i le trupat e lirë dhe shkon drejt e te shpirti. Padroni nuk thotë më: ose ju do të mendoni si unë ose do t’ju vras. Ai thotë: ju jeni të lirë të mos mendoni si unë: jeta juaj, të mirat tuaja materiale, mbeten tuajat, por që nga ky moment ju do të konsideroheni si një i huaj mes nesh.”*¹

Ky “skllavërim i vullnetshëm” duket si diçka natyrore, në emër të të cilit kryhen krime ndaj njerëzimit dhe një realitet i tillë, pra raporti ynë me të vërtetën, raporti me artin e me të tjerët të bën të mendosh më thellë se kaq, të vësh në diskutim çdo gjë duke vënë përballë mënyrën se si operojmë në shoqëri. Dhe në këtë shoqëri ku njerëzit zgjedhin pronarët, të cilët zhduken pas perdes teknologjike të aparatit të prodhimit e shkatërrimit, nuk kemi si të mendojmë ndryshe përveç faktit se jemi brenda një eksperimenti të madh, ku nuk jemi gjë tjetër, por marioneta në duart e të tjerëve apo thënë ndryshe, jemi bërë “Spektator Model” në kuptimin ekojan.

Pra, njeriu nuk pushon së qeni një instrument pune, trupi lejohet që të ekspozojë tiparet e tij në botën e përditshme të punës, dyqanet dhe zyrat shihen nëpërmjet dritareve gjigande prej xhami dhe e ekspozojnë personelin e tyre, si një nga arritjet unike të shoqërisë industriale, e cila e zëvendësoi punën fizike nëpërmjet kërkesave të industrisë së reklamave. Dhe ky është çmimi që shoqëria moderne e konsumit ofron mundësinë për të blerë “lirinë tonë”, duke punuar në mënyrë të paarsyeshme dhe më shumë sesa duhet, pa menduar për dëmet psikologjike që shkaktohen duke i shndërruar në një vegël të makinës industriale, në individ që rendin drejt punës, në individ

¹ Tocqueville, f. 32.

që nuk kanë më kohë për kënaqësi të tjera. Kujtojmë këtu filmin e famshëm të Charlie Chaplin, *Modern Times*², të vitit 1936 ku përshkruhet ajo që revolucioni industrial bëri me punëtorët.

E gjitha kjo na bën të pajtohemi me atë që Herbert Marcuse e quajti njeriu njëdimensional, sepse kemi të bëjmë me një shoqëri që mendon, flet, vepron, mohon dhe pajtohet sipas opinionit të përgjithshëm të turmës.

Marcuse kritikon ashpër “shoqërinë industriale të avancuar” e cila krijoi nevoja të reja për t’i integruar individët në sistemin ekzistues të prodhimit, konsumit, përmes masmedias, reklamimit, dhe mënyrave të të menduarit, duke pretenduar se kjo është formë e kontrollit të shoqërisë, dhe sistemi që ne jetojmë dhe pretendojmë se është demokratik, sipas Marcuses ai është totalitar. Ky racionalitet teknologjik i imponuar në çdo aspekt të kulturës dhe jetës publike ka maskuar natyrën shfrytëzuese të sistemit. Kjo shoqëri me kontroll teknologjik ndaj mendjes dhe materies, është parashikuar edhe nga George Orwell. *“Pushteti është pushtet mbi qeniet e tjera njerëzore. Mbi trupin por, mbi të gjitha, mbi mendjen.”*³

“1984”-a e Orwellit është një nga ata librat që koha nuk e përjashton, ai është e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja jonë dhe padyshim edhe e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja e brezave që do të vijnë. Kur flasim për romanin e Orwellit, jo detyrimisht po flasim për një regjim politik, totalitar, i cili dhunon fjalën e lirë, që ndërhyr në jetët e të tjerëve, që ngre akuza ndaj njerëzve me mendime ndryshe, por po flasim për një “diktaturë” të pranuar me dëshirë nga njerëzit, për një vëzhgim, përgjim deri në shtëpitë tona, të cilën me plot të drejtë mund ta quajmë diktaturë teknologjike. Pra, romani nuk është gjë tjetër, përveç se një vizion i zymtë i së ardhmes. Me shumë mjeshtëri, George Orwell flet në mënyrë të veçantë për temat e kontrollit të masmedias, librat, gazetatat, arkivat, për ekranet e televizionit që vëzhgojnë dhe përgjojnë, për metodat e manipulimit dhe kontrollimit të mendimeve, dhe kontrollin absolut mbi veprimet dhe ndërgjegjet e njerëzve.

*“Sytë të vëzhgonin gjithnjë kurse zëri të rrethonte. Në gjumë ose zgjuar, tek punoje apo haje, qoftë nëse ishe brenda apo jashtë shtëpisë, në banjë apo shtrat, nuk i shpëtoje dot. Asgjë nuk kishe tënden, përveç atyre pak centimetrave kub brenda kafkës sate.”*⁴

Prandaj, me të drejtë mund të themi se ajo që G. Orwell parashikoi për epokën e teknologjisë qëndron, sepse jeta e Uinstën Smith e vëzhguar nga teleekrani, nuk është thjesht një intrigë rolesh e situatash, apo një skenar dhe një vënie në skenë, por jeta e tij nuk është më ndryshe se ajo e të gjithë njerëzve të ditëve të sotme, ajo është tabloja në të cilën ne zhytemi çdo ditë. Secili nga ne është Uinstën Smith.

Por, koncepti i refolmes, uniformizimi i njerëzve, koncepti i turmës ishte i pranishëm qysh në Antikitë, kujtojmë Sokratin ku dënimi i tij bëhet për faktin se mendonte dhe vepronte ndryshe nga turma, dhe për faktin që ligjëratat e tij konsideroheshin shumëkuptimore, të dyshimta. Dhe pikërisht vendimi i 550 gjykatësve, dhe gjykimi në mënyrë kolektive i turmës bëri që Sokrati të ekzekutohej. Në historinë e njerëzimit kemi edhe emra të tjerë që turma në emër të drejtësisë ka bërë padrejtësitë më të mëdha, si: Galile Galileu, Xhordano Bruno, Jezu Krishti apo edhe personazhe të letërsisë botërore si, Manoli i N. Kazanxaqis, Jozef K, i Franc Kafkës, I huaji i Kamysë e emra të tjerë.

² Charlie Chaplin, *Factory Scene*, *Modern Times*

³ George Orwell, *1984*, Prishtinë, 2018, f. 112.

⁴ George Orwell, *1984*, Prishtinë, 2018, f. 39.

Parimet e Gjuhës së Re

George Orwell dhe Herbert Marcuse në veprat e tyre kanë parashikuar për gjuhën e re që do të zëvendësonte gjuhën e vjetër. Qëllimi i Gjuhës së Re nuk ishte vetëm ofrimi i një mjeti për të shprehur pikëpamjet mbi botën dhe zakonet mendore të pershtatshme për të përkushtuarit e Anglosocit, por edhe të bënte të pamundur mënyrat e tjera të mendimit.

Pra, synimi i të folmes së re që jo zgjerimi, por, përkundrazi, shkurtimi i rrezes së mendimit dhe ky pikësnyim arrihej tërthorazi duke pakësuar sa më shumë zgjedhjen e fjalëve. Fjalët e të folmes së re ndaheshin në tri kategori të dallueshme, të njohura si fjalësi A, fjalësi B, dhe fjalësi C.⁵

Edhe Marcuse në veprën e tij flet për gjuhën e mendimit njëdimensional, ku përveç të tjerave ndalet te shkurtimi i fjalëve. Sipas tij shumica e shkurtimeve janë të arsyeshme dhe të justifikueshme për shkak të gjatësisë që kanë, si psh NATO, SEATO, UN, AEC, AFL-CIO, por në të njëjtën kohë shkurtimet e fjalëve i sheh si një “dredhi e arsyes” për të frenuar pyetjet e padëshiruara. Pasi bëhet një fjalë zyrtare, e përsëritur vazhdimisht në përdorimin e përgjithshëm, shkurtimi e humb vlerën njohëse dhe shërben thjesht për pranimin e një fakti të pakundërshtueshëm.

Pra, sipas Herbert Marcuses gjuha e funksionalizuar, e shkurtuar dhe e unifikuar është gjuha e mendimit njëdimensional. E gjitha kjo rezulton në një univers “njëdimensional” të mendimit dhe sjelljes në të cilën aftësia dhe aftësia për mendim kritik dhe sjelljet kundërshtuese shuhet.

Përfundime

Siç e kemi parë gjatë punimit, objekti i këtij punimi ishte nxjerrja në pah dhe vështrimi komparativist i veprës së George Orwell, “1984”, dhe veprës së Herbert Marcuses, “*Njeriu njëdimensional*”.

Studimi i këtyre dy veprave, na jep mundësinë për të hyrë në thellësinë e teksteve, të cilat komunikojnë me lexuesin dhe e fusin atë në një botë tjetër, e cila mund të duket edhe si ikje ndaj botës reale, por edhe si nxitësin e një bote të tërë që fshihet. Pra, veprat janë një komunikim sa i qartë, aq edhe i nënkuptuar.

Gjatë këtij punimi kemi arritur të analizojmë hollësisht dukuritë dhe tiparet themelore të poetikave të veprave të dy autorëve, ato tipare që i bëjnë këta autorë të veçantë dhe të papërsëritshëm në letërsi, duke arritur në përfundime sa të përgjithshme, aq edhe specifike për temën.

Literaturë

- [1]. Orwell, G., *1984*, Pema, Prishtinë, 2018
- [2]. Marcuse, H., *One Dimensional Man*, Beacon Press, United States, 1964
- [3]. Marcuse, H., *Erosi dhe qytetërimi*, artikull studimor, 2010
- [4]. Pia Pozzato, M., *Semiotika e tekstit*, UET-Press, Tirana, 2009
- [5]. <https://www.youtube.com/watch?v=giJOYMaAc8s>

⁵ George Orwell, *1984*, Prishtinë, 2018, f. 381.